



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më _____.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ Datë ____ / ____ / 2025

Për një saktësim të Vendimit Nr. ____ datë ____ të Këshillit Bashkiak “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së dhe miratimin e financimit të FSHF-së për ndërtimin e Stadiumit Besa, si dhe dhënien e autorizimit të kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e saj”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligji nr. 44 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 8750, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, VKB Nr. 79 datë 19.12.2023, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit të vitit 2024” Kryetari Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e radhës:

TË VENDOSË

1. Pas pikës 2 të VKB Nr. ____, datë _____ shtohen nënpikat me këtë përmbajtje:
 - 2.1. Federata Shqiptare e Futbollit si i vetmi institucion në fushën e sportit të futbollit, do të jetë autoriteti që do të zhvillojë dhe përzgjedhë projektin e zbatimit me anë të prokurimit sipas kritereve të përcaktuara në procedurat e institucionit të saj. Në përzgjedhjen e projektit do të jenë anëtarë edhe përfaqësues të Bashkisë Kavajë.
 - 2.2. Procedura për përzgjedhjen e projektit fitues, zbatimit të projektit dhe supervizionimit të punimeve do të kryhet nga të dyja palët FSHF dhe Bashkia Kavajë.
 - 2.3. Investimi total, do të realizohet si më poshtë:
 - a. Gjatë fazës së miratimit të projektit, Bashkia Kavajë do të kontribuojë me 70% të vlerës së projektit, ndërsa Federata Shqiptare e Futbollit do të kontribuojë në masën 30%. Bashkia Kavajë do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, për llogari të Operatorit Ekonomik fitues.
 - b. Pjesa tjetër e investimit, do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, në përputhje me situacionet gjatë fazës ndërtimore, të cilat do të ndahen në raportin, 70% nga Bashkia Kavajë dhe 30% nga Federata Shqiptare e Futbollit.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE
Adrian Malaj

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE
Andi Çurgu



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Deshira Qato

DREJTORIA E KULTURËS, TURIZMIT, TRASHËGIMISË DHE SPORTEVE
Gentian Jaupi

SEKRETARI KESHILLIT
Meri Biturku

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Arti Çiçolli

KRYETARI
FISNIK QOSJA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË**

Nr. _____ Prot.

Kavajë, më _____.2025

RELACION

Për një saktësim të Vendimit Nr. 49 datë 30.09.2024 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së dhe miratimin e financimit të FSHF-së për ndërtimin e Stadiumit Besa, si dhe dhënien e autorizimit të kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e saj"

Bashkia Kavajë në projektet e saj të investimeve, ka si prioritet ndërtimin e Stadiumit Besa.

Stadiumi Besa pësoi dëmtime nga tërmeti i datës 26.1.2019.

Aktekspertiza e Institutit të Ndërtimit e ka vlerësuar shkallën e dëmit DS5.

Këshilli Bashkiak me vendimin Nr. 66, datë 23.06.2022 ka vendosur shembjen e detyruar, në zbatim të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Ndërtimi i stadiumit do të kapë vlerën prej 500 000 000 (pesëqind milion) .lekë

Kjo vlerë do të bashkëfinancohet në masën 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milion) lekë me të ardhurat e bashkisë dhe 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milion) lekë nga Federata Shqiptare e Futbollit ku projekt zbatimi i hartuar e miratuar nga Federata Shqiptare e Futbollit do të jetë i zbatueshem sipas standarteve të përcaktuara në këtë projekt nga Bashkia nëpërmjet kontraktorit të zbatimit të punimeve të përcaktuar sipas legjislacionit të prokurimeve publike dhe ndjekjes së punimeve nga të dy palët bashkëfinancuese.

Vlera e financimit nga Bashkia Kavajë do të shtrihet në një afat kohor për tre vjet.

Bashkia Kavajë ka kryer bisedime të shpeshta me FSHF-në dhe kanë nënshkruar një Aktmarrëveshje.

Federata Shqiptare e Futbollit si i vetmi institucion në fushën e sportit të futbollit, do të jetë autoriteti që do të zhvillojë dhe përzgjedhë projektin e zbatimit me anë të prokurimit sipas kritereve të përcaktuara në procedurat e institucionit të saj. Në përzgjedhjen e projektit do të jenë anëtarë edhe përfaqësues të Bashkisë Kavajë.

Procedura për përzgjedhjen e projektit fitues, zbatimit të projektit dhe supervizionimit të punimeve do të kryhet nga të dyja palët FSHF dhe Bashkia Kavajë.

Investimi total, do të realizohet si më poshtë:



a. Gjatë fazës së miratimit të projektit, Bashkia Kavajë do të kontribuojë me 70% të vlerës së projektit, ndërsa Federata Shqiptare e Futbollit do të kontribuojë në masën 30%. Bashkia Kavajë do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, për llogari të Operatorit Ekonomik fitues.

b. Pjesa tjetër e investimit, do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, në përputhje me situacionet gjatë fazës ndërtimore, të cilat do të ndahen në raportin, 70% nga Bashkia Kavajë dhe 30% nga Federata Shqiptare e Futbollit.

TË VENDOSË

1. Pas pikës 2 të VKB Nr.49 datë 30.09.2024 shtohen nën pikat me këtë përmbajtje:

2.1. Federata Shqiptare e Futbollit si i vetmi institucion në fushën e sportit të futbollit, do të jetë autoriteti që do të zhvillojë dhe përzgjedhë projektin e zbatimit me anë të prokurimit sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat e institucionit të saj. Në përzgjedhjen e projektit do të jenë anëtarë edhe përfaqësues të Bashkisë Kavajë.

2.2. Procedura për përzgjedhjen e projektit fitues, zbatimit të projektit dhe supervizionimit të punimeve do të kryhet nga të dyja palët FSHF dhe Bashkia Kavajë.

2.3. Investimi total, do të realizohet si më poshtë:

a. Gjatë fazës së miratimit të projektit, Bashkia Kavajë do të kontribuojë me 70% të vlerës së projektit, ndërsa Federata Shqiptare e Futbollit do të kontribuojë në masën 30%. Bashkia Kavajë do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, për llogari të Operatorit Ekonomik fitues.

b. Pjesa tjetër e investimit, do të disbursohet kundrejt faturimit online në sistem, në përputhje me situacionet gjatë fazës ndërtimore, të cilat do të ndahen në raportin, 70% nga Bashkia Kavajë dhe 30% nga Federata Shqiptare e Futbollit.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE

Adrian Malaj

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE

Andi Çurgu

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Deshira Qato

DREJTORIA E KULTURËS, TURIZMIT, TRASHËGIMISË DHE SPORTEVE

Gentian Jaupi